

URDHËR
Nr. 204, datë 30.3.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 56, të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Brendshme, z. Dritan Palnikaj, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të kësaj ministrie.

2. Delegimin e kompetencave për kryerjen e procedurave të prokurimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, sipas parashikimeve të vendimit nr. 81, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”.

3. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 30.3.2018 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1045, datë 18.10.2017, i ministrit të Brendshëm, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj